



Norwegian Embassy



Raportimi i medias mbi Reformën në Drejtësi

Periudha e monitorimit: Janar-Mars 2019

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqiptari për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqiptari për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

Raportimi i medias mbi Reformën në Drejtësi

Periudha e monitorimit: Janar-Mars 2019

Reforma në Drejtësi, Vetting-u në veçanti, si dhe ngritja dhe funksionimi i institucioneve që përbëjnë në vetvete këtë reformë janë tematikat kryesore të mjedisit politik dhe mediatik në Shqipëri, duke bërë që publiku të përballet vazhdimisht me retorikën që buron nga ky terren.

Tashmë jemi në fazën kur procesi i rivlerësimit të figurave vijon me ritme të kënaqshme, ndërsa janë ngritur vetëm një pjesë e organeve të pavarura të kontrollit.

Për të sjellë një panoramë të mënyrës se si po pasqyrohet Reforma në Drejtësi, si pjesë e monitorimit janë përzgjedhur kampione nga televizionet, shtypi i shkruar dhe mediat online.

Përzgjedhja e kampionit është bërë bazuar në kriterin e të pasurit të një audience të qenësishme, me një rol të mirëfilltë në informimin e publikut.

Vetë procesi i Reformës në Drejtësi është shoqëruar edhe nga një debat i fortë politik, ndaj dhe është bërë kujdes që pjesë e këtij kampioni të jenë media me këndvështrime të ndryshme në raport me reformën.

Mbi bazën e kësaj metodologjie, në mediat online është bërë përzgjedhja e portalit Balkanweb.com dhe Syri.net, si edhe gazetave "Panorama" dhe "Koha Jonë". Gjithashtu, pjesë e kampionit janë edhe edicionet qendrore të lajmeve të televizioneve "Tv Klan" dhe "Top Channel".

Monitorimi është bërë duke u fokusuar te lajmet për Reformën në Drejtësi, në përgjithësi, si dhe specifikisht për lajme ku përmenden Vetting-u dhe ngritja e funksionimi i KLP, KLGJ dhe SPAK-ut.

Sa i përket portaleve është bërë një vëzhgim i përditshëm dhe i detajuar i përmbajtjes së tyre në harkun kohor 1 janar - 31 mars 2019, duke identifikuar të gjitha lajmet dhe komentet që kanë të bëjnë me Reformën në Drejtësi në përgjithësi, duke i nëngrupuar më pas në lajme: a) mbi Vetting-un ose b) mbi KLP/KLGJ/SPAK-un.

Në përfundim është bërë një vlerësim cilësor mbi përmbajtjen dhe gjuhën e përdorur, dhe një vlerësim statistikor lidhur me raportin e lajmeve mbi Reformën në Drejtësi dhe totalit të lajmeve ditore të botuara në këto media.

Për dy gazetat janë përzgjedhur 45 numra për secilën prej tyre, për periudhën 4 janar - 31 mars 2019 ku gjithashtu është bërë një vlerësim mbi hapësirën që u është dhënë lajmeve që kanë të bëjnë me objektivin e monitorimit, qëndrimet editoriale si dhe gjuhën e përdorur.

Për televizionet gjithashtu janë vëzhguar 45 edicione qendrore lajmesh, përgjatë të njëjtës periudhë, duke analizuar posaçërisht përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e lajmeve mbi Reformën në Drejtësi në tërësi, si dhe Vetting-un dhe KLP, KLGJ dhe SPAK-un në veçanti.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur një mbulim të gjerë të procesit të Vetting-ut të Kryeprokurores së Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe personazheve të tjerë të njohur të Sistemit të Drejtësisë. Ndaj këtyre zhvillimeve është bërë një vlerësim i veçantë i qasjes mediatike, duke qenë se personazhet në fjalë kanë mbizotëruar debatin mediatik gjatë periudhës së monitoruar.

1. Një paraqitje e gjetjeve sasiore

I gjithë procesi i Vettingu-t, nga përballja me komisionerët, deri te publikimi i vendimit për kualifikimin e Kryeprokurores së Krimeve të Rënda, Donika Prea, ka qenë ngjarja që ka gjetur hapësirën më të madhe në të gjashtë mediat e monitoruara.


Përgjatë periudhës së sipërpërmendur, vërehet një shpërpjesëtim në lidhje me raportimet mbi Reformën në Drejtësi në përgjithësi, të procesit të Vetting-ut si dhe të institucioneve që janë ngritur në kuadër të saj.

Kjo diferencë vërehet më shumë te dy gazetat, ku njëra raporton në mënyrë periodike, thajse të përditshme mbi Reformën në Drejtësi, ndërsa tjera fokusohet kryesisht në çështje të caktuara. Një situatë e ngjashme vërehet edhe në dy mediat online, ku ndërkohë që njëra raporton rutinë mbi Vetting-un e gjykatësve dhe prokurorëve, tjetra raporton kryesisht mbi reagimet e politikës ndaj këtij procesi, duke u fokusuar gjithashtu te figura të rëndësishme të sistemit të drejtësisë në vend.

1.1. Televizionet

Reforma në Drejtësi ka gjetur pasqyrim të mirëfilltë në edicionet qendrore të lajmeve të televizioneve të monitoruara. Në edicionet e Top Channel vërehet një prani e dendur e kronikave mbi reformën me kohëzgjatje, shpesh më e gjatë sesa lajmet e tjera rutinë.

Në çdo dy edicione lajmesh të monitoruara, në njërin prej tyre gjendet një lajm mbi Reformën në Drejtësi. Në pesë raste, ose 11 për qind e kronikave janë hapur me lajm të parë Reformën në Drejtësi. Në dy raste, lajmi i parë ka qenë mbi Vetting-un, kurse në tre raste të tjera është raportuar mbi institucionet e reformës si KLP/ SPAK dhe KLGJ.



Figurë 1 Raportimi mbi Reformën në Drejtësi në edicionet qendrore të lajmeve në Top Channel dhe TV Klan, janar-mars 2019

Nga 620 kronika të transmetuara, 22 prej tyre ose 3.5 për qind e totalit kanë qenë mbi Reformën në Drejtësi, të ndara këto përkatësisht në 10 kronika mbi Vetting-un dhe 9 mbi KLP/ KLGJ/ SPAK me një kohëzgjatje mesatare 2 minuta.

Vetting-u zë një pjesë të mirë të raportimeve mbi reformën në këtë televizion, pavarësisht se tashmë jemi në periudhën kur janë ngritur një pjesë e mirë e institucioneve të tjera të Reformës në Drejtësi.

Në edicione të caktuara janë vërejtur kronika me një minutazh relativisht më të gjatë krahasuar me standardin e kohëzgjatjes së një kronike. Në këtë kuadër mund të veçohet edicioni i lajmeve i datës 28 janar, gjatë të cilit u transmetuan tre kronika me një minutazh total prej 7:25 minuta nga 25:13 minuta që ishte kohëzgjatja e të gjithë edicionit.

Në total, gjatë periudhës së monitoruar vërehet se në edicionet qendrore të lajmeve të Top Channel kohëzgjatja e kronikave mbi reformën në tërësi është rreth 44 minuta, ku 44 për qind e saj i përket Vetting-ut, 39 për qind KLP/KLGJ/SPAK-ut dhe pjesa tjetër lajme ku përmendet reforma në tërësi.

Gjatë periudhës së monitoruar, TV Klan ka transmetuar 13 kronika në lidhje me Reformën në Drejtësi, ku 6 prej të cilave kishin të bënin me Vetting-un, ndërsa 7 me KLP/ KLGJ dhe SPAK-un. Kronikat mbi reformën në tërësi përbëjnë 2 për qind të totalit prej 652 kronikash të transmetuara gjatë periudhës së monitoruar, me një avantazh tepër të lehtë (+1 në favor të kronikave mbi KLP/ KLGJ/ SPAK-un).

Kohëzgjatja totale e kronikave ishte 17 minuta e 48 sekonda, me një mesatare aritmetike prej 1 minutë e 22 sekonda për kronikë.

Kronikat e TV Klan janë përgjithësisht më të shkurtra, duke shpjeguar kështu edhe diferencën me Top Channel në lidhje me kohëzgjatjen. Vetë struktura e edicionit të lajmeve ka bërë që në mjaft raste informacioni mbi aspekte të reformës është dhënë me mbulim imazhesh, ndërkohë që spikeri lexon drejtpërdrejt lajmin në studio, ndërsa regjia e mbulon me pamje.


Përjashtim nga ky rregull është bërë në dy raste, gjatë periudhës në monitorim. Ato janë akuzat mbi raportin e njërit prej anëtarëve të KLP-së me ish-Sigurimin e Shtetit dhe vlerësimi nga KPK i figurës së Kryeprokurores së Krimeve të Rënda.

Vlen të theksohet se kronikat në lidhje me vlerësimin e figurës së Kryeprokurores së Krimeve të Rënda, dhe të akuzave mbi bashkëpunimin me ish-Sigurimin e Shtetit për anëtarin e KLP-së, Bujar Sheshi, kanë qenë relativisht më të gjata dhe më të thelluara.

Dy televizionet kombëtare e kanë pjesë të agjendës së tyre procesin e Reformës në Drejtësi, duke u fokusuar në zhvillimet që përbëjnë në thelb këtë reformë përmes raportimeve të thelluara. Kjo bën që të vërehen aspekte të ndjekjes në mënyrë proaktive të reformës pavarësisht qasjes së përgjithshme të medias në vend për të raportuar në mënyrë spontane, duke u ndikuar nga ngjarjet e ditës apo reagimet e partive politike.

1.2. Mediat online


Në mediat online vërehet një mbulim sporadik i Reformës në Drejtësi i ndikuar kryesisht nga ngjarjet e ditës si dhe të orientuar shpesh drejt debateve me burime politikanët apo partitë politike. Nga monitorimi i bërë në rubrikën e aktualitetit, të dy portalet “Balkanweb” dhe “Syri. Net”, rezulton se lajmet mbi Reformën në Drejtësi, në përgjithësi, si dhe KLGJ/ KLP/ SPAK në veçanti, janë në një nivel të papërfillshëm në raport me totalin e postimeve gjatë 24 orëve për secilin prej tyre vetëm në rubrikën e aktualitetit apo të lajmeve nga Shqipëria.



Figurë 2 Gjetjet gjatë periudhës janar-mars 2019 në "Balkanweb"

“Balkanweb” publikoi në total 5635 lajme në rubrikën e aktualitetit gjatë tre muajve të monitoruar, 96 prej tyre kishin lidhje direkt apo indirekt me Reformën në Drejtësi dhe organet që e përbëjnë. Lajmet mbi Reformën në Drejtësi përbëjnë 1.7% të totalit të postimeve mbi aktualitetin gjatë tre muajve. Nëse do të ishim edhe më specifike, rezultojnë se gjatë kësaj periudhe, në këtë portal janë publikuar 50 lajme që lidhen direkt me Vetting-un dhe 46 lajme që kanë të bëjnë me KLGJ/ KLP/ SPAK-un.

Syri.net rezultojnë me një numër më të madh lajmesh të publikuara, ndërsa ato që kanë të bëjnë me Reformën në Drejtësi dhe njësitë e reja të ngritura prej saj, vërehet se janë në numër të ulët se “Balkanweb”, me një shfaqje sa 0.56% e totalit të postimeve në rubrikën e aktualitetit. Nga 8183 postime të bëra, rezultojnë se vetëm 46 lajme kanë pasur të bëjnë me Reformën në Drejtësi.



Figurë 3 Raportimi mbi Reformën në Drejtësi gjatë periudhës janar-mars 2019 në "Syri.net"

Vlen të theksohet fakti se ndryshe nga edicionet e lajmeve në televizione, një pjesë e mirë e lajmeve mbi Reformën në Drejtësi te portalet kanë si burim fillestar deklaratat apo kundër-deklaratat e politikanëve ose të partive politike.


Ashtu siç pasqyrohet edhe në tabelën sipër, raportimi mbi Reformën në Drejtësi nuk lidhet me ndonjë strategji të redaksive për të mbuluar këtë zhvillim të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë në vend, por ndikohet nga zhvillimet e ditës.

Kështu, për shembull, muaji shkurt rezulton me numrin më të madh të lajmeve të raportuara për reformën (50% e totalit), pasi në këtë periudhë ka pasur disa zhvillime të rëndësishme siç janë vlerësimi i Kryeprokurores së Krimeve të Rënda, kandidimi i prokurores në detyrë për postin e Kryeprokurores si edhe akuzat ndaj njërit prej anëtarëve të KLP-së për lidhje me ish-Sigurimin e Shtetit. Përveç kësaj, gjatë kësaj periudhe, është vërejtur edhe numri më i madh i lajmeve me burim nga politikanët apo partitë politike.

1.3. Mediat e printuara

Te "Panorama" vihet re një qasje për t'i ndjekur më nga afër zhvillimet që kanë të bëjnë me reformën duke pasur edhe një gazetar të dedikuar për mbulimin e zhvillimeve nga gjykatat dhe prokuroria. Zhvillimet e rëndësishme nga reforma siç janë shkarkimi apo kualifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KPK, apo organizimi i KLP-së, gjejnë vend në faqet 4-5 ose 6-7 duke u

pasqyruar shpesh edhe në faqen e parë të gazetës. Kjo tregon se gazeta e sheh me përparësi të gjithë procesin.




Figurë 4 Raportimi mbi Reformën në Drejtësi te gazeta "Panorama" gjatë janar-mars 2019

Në 15 raste ose sa 16.6% të totalit të faqeve të para, gjatë periudhës së monitoruar, “Panorama” i ka dhënë hapësirë në kopertinë zhvillimeve mbi Reformën në Drejtësi, kundrejt 5 rasteve ose 5.5% të totalit të faqeve të para të “Koha Jonë”. Gjithsej, lajmet mbi Vetting-un dhe komponentët e tjerë të Reformës në Drejtësi kanë zënë një hapësirë prej 28.5 faqesh, me një mesatare aritmetike prej rreth 1/3 të faqes për çdo numër të “Panorama”, kundrejt 10 faqeve të “Koha Jonë”.

Kjo e fundit nuk raporton mbi veprimtaritë rutinë të komisioneve të vlerësimit apo të njësive të tjera si KLP apo KLGJ, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimet që shkaktojnë më tepër debat mbi legjitimitetin dhe ecurinë e Reformës në Drejtësi.

Thuajse gjatë gjithë janarit në këtë gazetë nuk bien në sy shkrime ku ceket reforma, ndërsa vërehet një fokus i veçantë gjatë fundit të muajit, ku për tre numra me radhë, gazeta “Koha Jonë” është hapur me lajme mbi kontaktet e njërit prej anëtarëve të KLP-së me ish-Sigurimin e Shtetit. Këto zhvillime, përveçse i ka pasqyruar në faqe të parë, “KJ” u ka dhënë një hapësirë të konsiderueshme në brendësi, duke i pozicionuar kryesisht në faqet 2-3. Raportimi është shoqëruar edhe me editorial në dy ditë rresht. Gjatë kësaj periudhë, në gazetë janë publikuar 17

lajme të fokusuara kryesisht te Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Gjatë periudhës së monitoruar, te “Koha Jonë” janë publikuar gjithsej 25 lajme, 2 editoriale dhe një koment në lidhje me Vetting-un dhe KLP.



Figurë 5 Raportimi i Reformës në Drejtësi te gazeta "Koha Jonë" gjatë janar-mars 2019

Të gjitha publikimet janë bërë në dy momente: Çështja “Sheshi” dhe Vetting-u i Kryeprokurores së Krimeve të Rënda, duke konfirmuar kështu faktin se kemi të bëjmë me një raportim spontan mbi Reformën në Drejtësi, i nxitur nga zhvillimet e ditës si edhe agjenda e politikës.

II -Raportimi mbi zhvillime të rëndësishme, mes mungesës së ekspertizës dhe mbizotërimit të skenës nga politika

2.1. Shkarkimi i Antoneta Sevdarit, një debat në rrafshin teknik dhe atë moral

Shkarkimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit i anëtares së KLP-së Antoneta Sevdari u pasqyrua në dy rrafshë në media, në atë teknik duke u bazuar tek argumentet e vendimit të KPA-së, dhe në atë politik, ku nuk munguan akuzat për influenca që ndikojnë vendimet për Vetting-un. Sevdari u kualifikua nga KPK në korrik të vitit 2018, por u shkarkua nga KPA pas ankimimit të vendimit nga Komisioneri Publik.

Në njërën prej mediave të monitoruara, bëhet raportim teknik¹ mbi shkarkimin e prokurores duke u fokusuar te procedura që u ndoq deri në marrjen e këtij vendimi, por ndryshe raportohet kjo ngjarje në një tjetër media. Syri.net ka publikuar letrën publike të prokurores, ku ndër të tjera ajo shkruan: Duke gjykuar nga rasti im, kam arsye të forta për të dyshuar nëse procesi i Vetting-ut po i shërben qëllimit, i cili unë besoj se është: ‘Largimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve të korruptuar dhe profesionalisht të paafte [...]Kur procesi i Vettingut filloi, unë, personalisht, u mbusha me shpresë, sepse besoja që drejtësia do të vihej në vend. Në rastin tim, fatkeqësisht, nuk ndodhi kështu¹.

“Balkanweb” ka ripostuar një shkrim të “BIRN Albania” ku shpjegohen shkaqet që çuan në shkarkimin e prokurores, si dhe jepen të dhëna mbi analizën e treguesve të pasurisë, sipas të cilës ishin të ardhurat e padeklaruara të bashkëshortit ato që i shkaktuan probleme².

Letra publike e Sevdarit është publikuar më datë 5 mars në faqet 6-7 të gazetës “Panorama”, duke u renditur si lajmi dytë më i rëndësishëm në faqen e parë me titullin. Një ditë më pas, gazeta thekson përmes një titulli të madh se shkarkimi i Antoneta Sevdarit cenoi besimin tek drejtësia. Gazeta ka publikuar një shkrim të gazetarit Besar Likmeta të BIRN ku shkruhet se shkarkimi i prokurores nga Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk mbështetet në frymën e Reformës në Drejtësi. Në shkrim thuhet: “Akuza e ngritur nga Komisioneri Publik dhe e miratuar me shumicë votash nga KPA se prokurorja Sevdari ka cenuar besimin publik, pasi bashkëshorti i saj ka siguruar të ardhura nga emigracioni në Greqi dhe Arabi Saudite, dekada më parë, një pjesë edhe para martesë, janë dritëshkurtra. Si mund të sigurohet një emigrant shqiptar në Greqi që punëdhënësi t’i paguajë taksat kur ai nuk ka status ligjor dhe aq më pak, t’i imponohet një kompanie në Arabinë Saudite, një vend i njohur botërisht për shkelje të të Drejtave të Njeriut?”³

2.2. Rasti “Sheshi” dhe debatet mbi qëllimin final të Reformës në Drejtësi

Debati mbi të shkuarën e njërit prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Bujar Sheshi pas akuzave në media dhe më pas nga opozita se kishte qenë bashkëpunëtor i ish-

¹ <https://www.syri.net/politike/235457/u-shkarkua-nga-kpa-sevdari-leter-nderkombetareve-vettingu-u-kthy-ne-nje-proces-te-korruptuar/>

² <https://balkanweb.com/anetare-e-klp-shkarkohet-prokurorja-antoneta-sevdari/>

³ <http://www.panorama.com.al/shkarkimi-i-antoneta-sevdarit-pse-u-cenua-besimi-te-drejtësia-pasiguri-per/>

Sigurimit të Shtetit ka qenë tema mbizotëruese në lidhje me reformën dhe institucionet e saj gjatë gjysmës së dytë të muajit janar, i cili është karakterizuar nga një numër më i vogël raportimesh të ndikuara prej pushimeve të fundvitit, por edhe të një intensiteti më të ulët të politikës me deklarata që kanë të bëjnë me reformën, të cilat gjejnë hapësira edhe në media.

Referuar këtij debati, gazeta “Koha Jonë” shkruan se “përfshirja e ish-sigurimsave në organet e reja të Reformës në Drejtësi e vë seriozisht në pikëpyetje atë”. Rasti Sheshi ka gjetur hapësirë të madhe në këtë gazetë, e cila është hapur për tre numra me radhë me tituj të mëdhenj mbi këtë çështje. Më datë 27 janar, “Koha Jonë” hapet me titullin “Spiunë të vjetër në Drejtësinë e re?” duke i kushtuar faqet 2 dhe 3 si edhe një editorial ku ndër të tjera shkruhet se “katapultimi i një ish-sigurimsi në organet më të larta të Reformës në Drejtësi pa u konstatuar nga asnjëri prej organeve të tjera që bëjnë verifikimet përkatëse do të thotë se reforma ka dështuar plotësisht”.

Raportimi vijon edhe me botimin e akuzave të opozitës, sipas të cilave mazhoranca në këtë mënyrë po kap drejtësinë e re, duke kërkuar njëkohësisht edhe shkarkimin e Kryeprokurores Arta Marku me argumentin se certifikoi Sheshin pa pritur konfirmimin e Autoritetit të Dosjeve. Me këtë argument hapet edhe numri i datës 30 janar i “Koha Jonë”, ndërsa në 29 janar spikat kryetitulli “Prokurori që grisi Reformën në Drejtësi”, ku ndër të tjera, sërish përmes një editoriali në faqen nr.3 hidhen dyshime të forta mbi rezultatet e Reformës në Drejtësi. Në editorial pasqyrohet shqetësimi se “Reforma në Drejtësi u mirëprit nga 96% e shqiptarëve por emërimet e bëra së fundmi duke aplikuar dy standarde po rrisin dyshimet se qeveria ka futur duart aty”.

Në një linjë të ngjashme me “Koha Jonë” ka raportuar edhe “Syri.net”. Në një shkrim të datës 25 janar, portali⁴ u referohet dokumenteve të botuara në një tjetër media, duke theksuar se “futja e një ish-sigurimsi në organin që kontrollon prokurorinë është një veprim i qëllimshëm i mazhorancës për të ndikuar KLP-në”. Gjatë ditëve në vijim të këtij debati, Syri.net i referohet deklaratave të zyrtarëve të lartë të opozitës, në të cilat përmes Sheshit shfaqet skepticizmi mbi qëllimin final që mazhoranca sipas tyre ka me implementimin e Reformës në Drejtësi⁵.

⁴ <https://www.syri.net/politike/226952/anetari-i-klp-spiun-i-sigurimit-te-shtetit-me-pseudonimin-venusi-ja-emri/>

⁵ <https://www.syri.net/politike/227110/loja-e-piste-e-rames-per-kapjen-e-drejtises-ku-gaboi-prokurori-sigurims-ge-e-dekonspiruan/>

Ndryshe nga “Koha Jonë” dhe “Syri.net”, “Panorama”, televizionet “Top Channel” dhe “Tv Klan”, si dhe “Balkanweb” vërehet se janë fokusuar kryesisht vetëm në deklaratat e institucioneve dhe individëve të përfshirë në çështjen “Sheshi”, pa mbajtur një qëndrim editorial ndaj subjektit. “Panorama” e ka pozicionuar këtë çështje në një vend të dukshëm të faqes së parë përgjatë datave 27-28-29 janar, ndërsa në brendësi i është dhënë hapësirë dy faqe kryesisht në faqet 4-5.

“Top Channel” gjithashtu është fokusuar në këtë çështje. Kohëzgjatja e kronikave mbi rastin “Sheshi” dhe akuzave politike që lidhen me të dhe Reformën në Drejtësi kanë përbërë përkatesisht 15.3 dhe 19% të kohëzgjatjes totale të edicioneve të lajmeve të datave 26 dhe 28 janar. Me një kohëzgjatje disi më të vogël, i njëjti fenomen vërehet edhe tek edicionet e TV Klan për të njëjtën periudhë.

Rasti “Sheshi” nxori në pah një problematikë tjetër të medias në vend, siç është orientimi i agjendës në varësi të deklaratave prej podiumeve të partive. Akuzat ndaj anëtarit të KLP-së ishin publikuar dy ditë më parë në një tjetër media online, por ato gjetën hapësirë të madhe mediatike pasi Partia Demokratike mbajti një konferencë për shtyp për këtë çështje. Referuar kësaj konference për shtyp, “Syri.net” shkruan se “mazhoranca është duke bërë një lojë të pisët përmes futjes së një ish-sigurimi në KLP”⁶. “Balkanweb” i referohet sërish një deklaratë për shtyp të një zyrtari të lartë demokrat, i cili kërkon “shkarkimin e Kryeprokurores për shkelje të ligjit gjatë procesit të ngritjes së KLP-së duke lejuar futjen aty edhe të Bujar Sheshit”⁷. Publikime të ngjashme gjen edhe në mediat e tjera në monitorim.

2.3. Vlerësimi i Prelës, mes debatit politik dhe shqetësimit të medias për standardin e zbatuar

Vetting-u i Kryeprokurores së Krimeve të Rënda, Donika Prela shënon numrin më të madh të publikimeve që kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me një subjekt në procesin e Vetting-ut përgjatë periudhës së monitoruar.

⁶ <https://www.syri.net/politike/227110/loja-e-piste-e-rames-per-kapjen-e-drejtises-ku-gaboi-prokurori-sigurims-ge-e-dekonspiruan/>

⁷ <https://balkanweb.com/pd-dashuria-me-arta-markun-mbaroi-sigurimsi-sheshi-do-digjet/>

Kjo vëmendje ndaj Prelës u theksua sidomos pas publikimit të vendimit të KPK-së për kualifikimin e saj si prokurore. Media u fokusua kryesisht në treguesit e pasurisë së kreut të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, të cilat komisioni i vlerësoi kaluese, ndërkohë që me të njëjtin argument kishte shkarkuar një gjykatës të rëndësishëm në vend.

“Top Channel” transmetoi në edicionet qendrore të lajmeve tre kronika kushtuar Vetting-ut të Prelës, debatet me ONM-në, si dhe argumentet e kualifikimit të saj me një kohëzgjatje totale prej 7 minuta e 50 sekonda me një kohëzgjatje mesatare 2.36 minuta, rast ky që bën përjashtim nga kohëzgjatja normale e kronikave në këtë televizion (mesatarisht 1.40 min). Në këtë minutazh spikat konstatimi i përfaqësuesit të ONM-së Theo Jacobs mbi pasurinë e subjektit Prela. “TV Klan” transmetoi 5 kronika me një fokus të ngjashëm dhe një kohëzgjatje totale 8 minuta e 17 sekonda.

Në portale rezultojnë 22 postime që kanë të bëjnë direkt me Vetting-un e subjektit në fjalë me një mesatare 3-4 lajme në ditë në përgjatë periudhës 20-24 janar kur u vlerësua nga KPK si dhe 27-29 mars, kur u publikua vendimi, kurse në gazeta, ajo është nxjerrë në faqe të parë sa herë që ka pasur lajme rreth saj, gjatë periudhës së monitoruar. Prela është konstatuar 5 herë në faqen e parë të “Panorama” dhe “Koha Jonë”, gjatë dy periudhave të mësipërme, me një prezencë prej 12 lajmesh që lidhen drejtpërdrejt me emrin e saj.

Kualifikimi i saj nga KPK shoqërohet me një debat të fortë në media, ku spikasin ato pranë opozitës, të cilat i mëshojnë qëndrimit se “ky vendim njollosoi përfundimisht Reformën në Drejtësi”. Në një prej mediave opozitare shkruhet se kualifikimi i kreut të Prokurorisë së Krimeve të Rënda u bë me “dhunë” dhe ndërhyrje pasi njëri prej tre anëtarëve të KPK-së ishte kundër⁸. Një tjetër autor shkruan në “Koha Jonë” se “Kualifikimi i Prelës është një tjetër arsye pse opozita duhet të djegë mandatet”⁹. “Panorama” ka nxjerrë dukshëm në faqe të parë vendimin e KPK-së që kualifikon Prelën, duke i vënë kësaj ngjarjeje gjithashtu në dispozicion dy faqe. “Panorama” shkruan në 28 mars: “Vendimi i KPK-së bie ndesh me qëndrimin e Komisionerit

⁸ <https://www.syri.net/politike/229279/e-kapur-nga-krimi-kush-eshte-sanxhaktari-njeriu-i-bandave-dhe-rames-ne-vetteing/>

⁹ <http://www.kohajone.com/2019/02/20/andi-bushati-donika-prela-nje-arsye-me-shume-pse-duhen-djegur-mandatet/>

Publik dhe vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në rastin e ish-kreut të Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja. Në këtë vendim, KPA është shprehur se “sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës konsiderohen të ardhura të ligjshme ato që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

Ajo që vërejnë mediat lidhet me dyshimet mbi një standard të dyfishtë të komisionit të vlerësimit për shkak se për të njëjtat problematika, një subjekt kualifikohet, kurse një subjekt tjetër dërgohet në apel ku edhe shkarkohet.¹⁰

2.4. Vendimi për Dritan Dajtin, një debat krejtësisht në rrafsh politik

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda për t’i njohur Dritan Dajtit të drejtën e gjyqimit të shkurtuar, duke i hequr praktikisht dënimin e përjetshëm, shkaktoi një reagim të fortë publik, i cili u pasqyrua edhe në media. Edhe pse ngjarja nuk lidhet drejtpërdrejt me Reformën në Drejtësi, ajo u trajtua në media e parë tërësisht nën këtë prizëm, dhe me argumentin kryesor se “reforma është një domosdoshmëri për të shpëtuar njëherë e mirë nga trupa gjykuese që japin vendime të tilla”¹¹.

Debati mbi vendimin e Gjykatës së Apelit është zhvilluar kryesisht në rrafshin politik me akuza dhe kundërakuza mes qeverisë dhe opozitës, ku në një pjesë të mirë të rasteve media është bërë ndërmjetëse e pingpongut politik. Vihet re një mesazh i përqendruar i mazhorancës në lidhje me këtë ngjarje, ku narrativa fokusohet pikërisht te nevoja për të përfunduar sa më parë Reformën në Drejtësi, ndërsa opozita i mëshon skepticizmit ndaj reformës duke theksuar se gjyqtarët po mbarojnë pazaret para se të kalojnë Vetting-un¹².

Ky debat i fortë politik ka bërë që të mungojë një analizë shteruese e rrethanave që çuan në vendimin e mësipërm të gjykatës, pa i mundësuar publikut të kuptojë se çfarë ka ndodhur përmes një zëri të pavarur.

¹⁰ Gjatë periudhës që po përgatitej ky raport, vendimi i KPK për Donika Prelën u ankimua në KPA.

¹¹ <https://balkanweb.com/dritan-dajti-rama-akt-kriminal-do-e-zhbejme-vendimin/>

¹² <https://www.syri.net/politike/230090/pd-edi-rama-ndihmon-dritan-dajtin-ti-shpetoje-burgut-te-perjetshem/>

2.5. Mungesa e ekspertizës gjatë raportimit mbi Reformën në Drejtësi

Kalimi nga diskutimi i përgjithshëm në atë specifik në lidhje me reformën, si dhe organet që e përbëjnë atë, nxjerr në pah problematikën mungesës së ekspertizës gjatë raportimit për këto tematika. Është vërejtur se për raste që kërkojnë ekspertizë, mediat e printuara dhe ato online kanë zgjedhur më shumë t'i referohen publikimeve të “BIRN Albania”¹³ në lidhje me pasuritë e subjekteve në vlerësim sesa të kenë një përmbajtje origjinale të tyre. Kjo dukuri ka nxjerrë në pah edhe problematika që lidhen me uniformitetin e informacionit, ku një publikim i nxjerrë diku merret dhe ripostohet në platforma të tjera online, duke mos mundësuar këndvështrime të ndryshme në lidhje me zhvillimet e rëndësishme për Reformën në Drejtësi.

Publikimi i mësipërm gjeti hapësirë të plotë edhe në versionin print të gazetës “Panorama” në numrin e datës 28 mars.

Gjithashtu vërehen raste të mungesës së njohurive të gazetarit mbi rolin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit apo edhe njësive të tjera të ngritura rishtas duke krijuar pështjellim të lexuesi.

Një problematikë e tillë vërehet kryesisht te portalet, ku ndikojnë më së shumti edhe mungesat në burime njerëzore të redaksive në fjalë, ku një gazetar duhet të postojë njëkohësisht për disa sektorë, pa pasur as hapësirën kohore as mundësinë fizike për t'u fokusuar në një lajm.

2.6. Reforma: pritshmëri dhe realitete

Reforma gjithashtu shihet si e vetmja mundësi për të siguruar funksionimin e shtetit ligjor dhe riformatimin e klasës politike në vend, duke i bërë pritë një sërë problematikave të hasura më parë në procesin e përgatitjes dhe mbarëvajtjes së zgjedhjeve, ku veçohet blerja e votës. Autori shkruan në “Panorama”¹⁴ se “partitë politike do të duhet t'i bëjnë tashmë llogaritë sipas këtij realiteti të ri që do të krijohet në vend”.

¹³ <https://balkanweb.com/vendimi-per-donika-prelen-kpk-i-njohu-te-ardhurat-e-pataksuara/>

¹⁴ <http://www.panorama.com.al/analiza-shanset-e-protestes-se-opozites-si-mund-ti-beje-per-vete-basha-500-mije-votuesit-e-spak/>

Në pjesën e komenteve pasqyrohet dhe një optimizëm për realizimin sipas afateve të parashikuara të Reformës në Drejtësi, ndërkohë që herë pas here hasen shkrime dhe komente nga autorë të ndryshëm¹⁵, të cilët theksojnë se reforma po shtyhet përpara nga SHBA dhe Perëndimi, të cilët “janë të interesuar për stabilitet, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajon përmes funksionimit të sistemit të drejtësisë”.

Në media vërehet në mënyrë të përsëritur problematika e vonesës së ngritjes dhe funksionimit të organeve që përbëjnë Reformën në Drejtësi, në një shkrim të botuar në “Panorama”, autorja shprehet: “E ndërsa vetingu po vijon me hapa të ngadaltë e SPAK-u do të marrë dhe ca kohë të ndezë motorët për t’u nisur, dhjetëra gjyqtarë e prokurorë të korruptuar e joprofesionalë anembanë Shqipërisë vijojnë qetësisht “punët” (lexo: shpërdorime detyre. Shënim i redaktorit) e tyre¹⁶.

Shqetësimet mbi problematikën që po vërehen në aktivitetin e përditshëm të gjykatave dhe prokurorive hasen shpesh në media, ku mbizotëron mendimi se vonesat në implementimin e reformës me të gjithë komponentët e saj bën që prokurorë dhe gjykatës të caktuar të japin vendime që nuk do të mund t’i jepnin në situata normale, duke liruuar nga burgu apo lehtësuar dënimet për personazhe të njohur të krimit në vend.

PËRFUNDIME

Reforma në Drejtësi shihet në mediat shqiptare si një zhvillim i rëndësishëm për vendin. Në media nuk vërehen zëra kundër reformës, edhe pse nuk mungojnë zërat skeptikë për mënyrën se si po implementohet ajo. Në mediat opozitare, si dhe tek ato që shihen si më pranë opozitës, në qëndrimet e tyre vërehet një shqetësim që lidhet me faktin se ndikimet politike po e dëmtojnë atë duke e bërë që të mos i shërbejë vendit.

Ndërkohë, raportimi mbi Reformën në Drejtësi është dhe duket se do të vijojë të jetë një sfidë për median dhe gazetarët në Shqipëri, e cila rrjedh nga fakti se ndryshimet ishin tepër drastike duke bërë të nevojshme njohjen dhe më pas transmetimin e tyre te publiku nga gazetarë të mirëpërgatitur.

¹⁵ <http://www.panorama.com.al/euroatlantizmi-zgjidhja-per-nje-ballkan-ne-paqe-e-te-zhvilluar/>

¹⁶ <http://www.panorama.com.al/agonia-e-nje-sistemi>

Gjatë periudhës së monitoruar është vërejtur një fokusim i raportimeve dhe debatit nga aspektet e Reformës në Drejtësi në përgjithësi, siç ka qenë gjatë periudhës kur ajo filloi të implementohej, të zhvillimet specifike në lidhje me të, siç janë procesi i vlerësimit të figurës së gjykatësve, prokurorëve dhe punonjësve të administratës së këtij sistemi, si edhe zhvillimet në KLP dhe KLGJ.

Këto zhvillime kërkojnë një njohje më të mirë nga ana e gazetarëve, ekspertizë e cila mungon përgjithësisht në media. Mungesat financiare dhe problemet me stabilitetin e përgjithshëm të tregut mediatik bëjnë që në redaksi të mungojnë përgjithësisht gazetarët që mund të lexojnë në mënyrën e duhur realitetin e ri që është krijuar.

Për shkak të kësaj dukurie, vërehen shpesh elemente të uniformitetit të informacionit, ku e njëjta përmbajtje, sidomos kur bëhet fjalë për çështje teknike, ripostohet edhe në media të tjera pa ndryshime thelbësore në të. Po ashtu vërehet edhe një mungesë e njohurive mbi fushën e veprimtimit të KPK-së, KPA-së, apo dhe të institucioneve të ngritura rishtas për shkak të Reformës në Drejtësi.

Agjenda e medias për të raportuar mbi Reformën në Drejtësi vijon të ndikohet prej agjendës së politikës, ku një pjesë e mirë e përmbajtjes ka si burim pikërisht akuzat dhe kundërakuzat nga politikanët dhe podiumet e partive politike. KPK ka vijuar normalisht punën për vlerësimin e figurës së anëtarëve të Sistemit të Drejtësisë në vend, por Vetting-u është bërë lajm kryesor në media vetëm pasi mbi këto zhvillime kanë reaguar partitë politike. Edhe në këtë rast, fokusi ka qenë të deklaratat, duke munguar një analizë e mirëfilltë e zhvillimeve në mënyrë që publiku të kuptojë se çfarë po ndodh realisht.

Disa zhvillime të rëndësishme gjatë Vetting-ut janë bërë shpesh shkak që Reforma në Drejtësi të shihet me skepticizëm në media. Kujtojmë këtu se shkarkimi i pjesës më të madhe të prokurorëve dhe gjyqtarëve vetëm duke u bazuar në kriterin e pasurisë ka bërë që media të vërë në pikëpyetje faktin nëse vërtet Vetting-u po zhvillohet sipas frymës së Reformës në Drejtësi apo kemi të bëjmë me një përlllogaritje të ftohtë të të ardhurave dhe shpenzimeve duke mos u marrë me aspekte të tjera, siç janë profesionalizmi apo figura morale e subjektit të vlerësuar.

Zhvillimet mbi Reformën në Drejtësi gjejnë hapësirë në mediat shqiptare, por në to mungon raportimi analitik, ndërkohë që skena mbizotërohet prej debatit të mirëfilltë politik duke bërë që audienca të mos kuptojë rëndësinë e këtij procesi për vendin dhe realitetin e ri që po krijohet.